



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

AUTORIZIM

Nr. 01, datë 08/3 /2019

Në mbështetje të nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit nr. 48 datë 14.09.2018 “Për çertifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”, pasi mora në shqyrtim kërkesën për autorizim nr. 137 Prot., datë 29.01.2019 të paraqitur nga organizmi i çertifikimit Legal Cert Shpk., i akredituar sipas Standardit ISO/IEC 17021-1:2015 për çertifikimin e sistemeve të menaxhimit në përputhje me Standardin ISO/IEC 27001:2013,

KONSTATOVA SE:

Organizmi i çertifikimit Legal Cert Shpk, përmbush kriteret e listuara në nenin 8 të Udhëzimit nr. 48 datë 14.09.2018 “Për çertifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Udhëzimit nr. 48 datë 14.09.2018 “Për çertifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”

V E N D O S A:

1. Autorizimin e organizmit të çertifikimit Legal Cert Shpk si Organizëm i Akredituar në kuptim të nenit 3, pika 2 e Udhëzimit nr. 48 datë 14.09.2018 “Për çertifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”
2. Ky autorizim është i vlefshëm deri me datë 18.12.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

